

# **Statuti i Shoqates Rajonale e Futbollit Fier**

2021

## **PËRKUFIZIMET**

Termet e përdorura më poshtë do të kuptohen si vijon:

**SHRFF:** Shoqata Rajonale e Futbollit Fier

**FSHF:** Federata Shqiptare e Futbollit.

**Gjykata e Arbitrazhit:** një gjykatë private e pavarur dhe e krijuar në mënyrën e duhur, e cila vepron në vend të një gjykate të juridiksionit të zakonshëm.

**Asambleja e Përgjithshme:** organi më i lartë dhe legjislativ i SHRFF-së.

**Federata:** një shoqatë futbollit e njohur si e tillë nga FIFA dhe nga konfederata përkatëse. Ajo është anëtare e FIFA-s, përveç se nëse nga konteksti del i qartë një kuptim tjetër.

**Futbolli:** loja/gara e kontrolluar dhe e organizuar nga FIFA, konfederatat dhe/ose FSHF në përputhje me Ligjet e Lojës.

**CAS:** Gjykata e Arbitrazhit për Sportin, me seli në Lozanë (Zvicër).

**Klubi:** anëtar i FSHF-së, ose anëtar i një lige të njohur nga FSHF që ka të paktën një skuadër në një garë të organizuar nga FSHF ose SHRFF.

**Konfederata:** një grup shoqatash të njohura nga FIFA, të cilat i përkasin të njëjtit kontinent (ose një rajoni gjeografik të ngjashëm).

**Delegat:** person fizik që përfaqëson në mënyrë të vlefshme një anëtar me anëtarësi të drejtpërdrejtë në Asamblenë e Përgjithshme.

**FIFA:** Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Futbollit.

**Ligjet e Lojës:** Ligjet e Federatës së Futbollit të nxjerra nga IFAB në përputhje me dispozitat përkatëse të statuteve të FIFA-s.

**Anëtar:** person juridik që është pranuar me anëtarësim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të SHRFF nga Asambleja e Përgjithshme.

**Zyrtar:** çdo anëtar i komisioneve, arbitër dhe ndihmësarbitër, trajner dhe çdo person tjetër përgjegjës për çështje teknike, mjekësore dhe administrative në FIFA, UEFA, FSHF, një ligë ose një klub, si dhe çdo person tjetër i detyruar të veprojë në përputhje me statutin e FIFA-s, UEFA-s ose FSHF-së (përveç lojtarëve dhe ndërmjetësve).

**Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm:** gjykatat e brendshme të shtetit, të cilat trajtojnë mosmarrëveshjet juridike publike dhe private.

**Lojtar:** futbollist i licencuar nga FSHF.

**IFAB:** Bordi i Shoqatës Ndërkombëtare të Futbollit (IFAB).

**UEFA:** Bashkimi i Shoqatave Evropiane të Futbollit.

**Qarku Sportiv Fier:** Teresia e territoriale qe përfshin bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Lushnje, Divjakje, Mallakaster, Vlore, Selenice, Himare;

Shënim. Termat që u referohen personave fizikë përfshijnë të dyja gjinitë. Çdo term në njëjës vlen edhe për shumësin dhe anasjelltas.

## I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

---

### Preambula

---

Shoqata Rajonale e Futbollit Fier është themeluar më Vendimin nr.5728, datë 19.01.2018. dhe është anëtare e Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF). Shoqata Rajonale e Futbollit Fier, nën mbikëqyrjen e FSHF është entiteti i vetëm kompetent për të organizuar futbollin në Qarkun Sportiv Fier.

---

### Neni 1 Forma juridike, selia dhe markat

---

1. SHRFF është person juridik, e organizuar si shoqatë, e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave dhe klubeve sportive të futbollit në Qarkun Sportiv Fier, të cilat veprojnë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr. 8789, datë 27.5.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, ligjit nr. 79/2017 “Për sportin” dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore që drejtojnë këtë aktivitet. Ajo është themeluar me një afat të pacaktuar kohe.
  2. Selia e SHRFF-së ndodhet në Fier, Rr “Brigada 11 Sulmuese”.
  3. SHRFF është anëtare e FSHF.
  4. Vula e SHRFF -së është rrethore dhe përfshin emblemën e SHRFF-së.
  5. Akronimi i Shoqatës Rajonale të Futbollit Fier është SHRFF.
- 

### Neni 2 Objektivat

---

Objektivat e SHRFF-së janë:

- a) Të përmirësojë vazhdimisht lojën e futbollit dhe ta promovojë, ta rregullojë dhe kontrollojë atë në të gjitha format e saj në të gjithë territorin e Qarkut Sportiv Fier në dritën e lojës së ndershme dhe vlerave të saj bashkuëse, edukative, kulturore dhe humanitare, veçanërisht përmes programeve të rinisë dhe zhvillimit;
- b) Të organizojë gara futbollit në të gjitha format e njohura nga FSHF, FIFA dhe UEFA duke përfshirë por pa u kufizuar tek futsalli ose futbollit në rërë, në Qarkun Sportiv Fier;
- c) Të hartojë rregullore dhe dispozita dhe të sigurojë zbatimin e tyre;
- d) Të mbrojë interesat e futbollit dhe të anëtarëve të saj, dhe të ndihmojë anëtarët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre;
- e) Të kontrollojë dhe të parandalojë çdo shkelje të statuteve, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FIFA-s, UEFA-s dhe FSHF-së si dhe ligjeve të lojës, dhe të sigurojë që ato të respektohen edhe nga anëtarët;
- f) Të promovojë integritetin, etikën dhe lojën e ndershme me qëllim parandalimin e të gjitha metodave ose praktikave, të tilla si korrupsioni, dopingu ose manipulimi i ndeshjeve, të cilat mund të rrezikojnë integritetin e ndeshjeve, garave, lojtarëve, zyrtarëve dhe anëtarëve ose të shkaktojnë abuzim me futbollin, futsallin ose futbollin në rërë;

- g) Të promovojë dhe të forcojë parimet dhe praktikat e qeverisjes së mirë në nivelin kombëtar dhe të inkurajojë anëtarët e saj të miratojnë parimet e qeverisjes së mirë, brenda vetë anëtarëve;
- h) Të promovojë zhvillimin e futbollit të femrave dhe pjesëmarrjen e plotë të femrave në të gjitha nivelet;
- i) Të kontrollojë dhe të mbikëqyrë të gjitha ndeshjet miqësore të futbollit të të gjitha formave të luajtura në të gjithë territorin e Qarkut Sportiv Fier;
- j) Të kontrollojë dhe të mbikëqyrë futbollin, futsallin dhe futbollin në rërë, në Qarkun Sportiv Fier, në përputhje me statutin dhe rregulloret përkatëse të FSHF-se; FIFA-s dhe të UEFA-s;
- k) Të promovojë dhe të mbështesë iniciativat e anëtarëve të saj, për rritjen e të ardhurave të tyre në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë;
- l) Të sigurojë transparencë për aktivitetet e saj.

---

### Neni 3 Detyrimet

---

SHRFF merr përsipër:

- a) Të investojë të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i sajë për futbollin në Qarkun Sportiv Fier;
- b) Të respektojë në çdo kohë statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHF-së, si dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë, statutin e FSHF-së dhe rregullore të tjera të detyrueshme për SHRFF-në;
- c) Të luajë rol aktiv lidhur me aktivitetet sportive të FSHF-së;
- d) Të respektojë parimet e besnikërisë, integritetit dhe sportivitetit në frymën e lojës së ndershme;
- e) Të respektojë Ligjet e Lojës të miratuara nga IFAB, si dhe Ligjet e Futbollit të Rërës dhe të Minifutbollit, të nxjerra nga FIFA;
- f) Të njohë juridiksionin e CAS-it, siç specifikohet në dispozitat përkatëse të statuteve të FIFA-s, UEFA-s dhe FSHF-së;
- g) Të administrojë punët e saj në mënyrë të pavarur dhe të sigurojë që çështjet e veta të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë dhe të parashikojë një procedurë që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve të anëtarëve të organeve të SHRFF-së, në veçanti një procedurë e cila është e pavarur nga çdo ndërhyrje apo ndikim i papërshtatshëm politik;
- h) Të veprojë në përputhje me konventat e antidopingut dhe dispozitat e tjera të legjislacionit në fuqi;
- i) Të sigurojë që anëtarët, klubet, lojtarët, zyrtarët, ndërmjetësit dhe agjentët të bien dakord, se përmes statuteve të tyre, licencës, regjistrimit ose cdo dokumenti tjetër të shkruar, do të respektojnë detyrimet e sipërpërmendura;
- j) Të komunikojë me FSHF-në lidhur çdo ndryshim të statutit të SHRFF-së.

---

Neni 4 **Të drejtat e njeriut**

---

SHRFF është e angazhuar të respektojë të gjitha të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht dhe do të përpiqet të promovojë mbrojtjen e këtyre të drejtave.

---

Neni 5 **Mosdiskriminimi dhe barazia**

---

Diskriminimi i çdo lloji kundër një vendi, personi privat ose grupi të njerëzve për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës etnike, kombëtare ose shoqërore, gjinisë, paaftësisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose ndonjë mendimi tjetër, pasurisë, lindjes ose ndonjë tjetër statusi, orientimi seksual ose ndonjë arsye tjetër është rreptësisht i ndaluar dhe i dënueshëm me pezullim ose dëbim dhe/ose masa të tjera disiplinore.

---

Neni 6 **Neutraliteti dhe pavarësia institucionale**

---

1. SHRFF është neutrale lidhur me çështjet e politikës dhe të fesë.
  2. Anëtarët e SHRFF-së do të jenë gjithashtu neutralë lidhur me çështjet e politikës dhe fesë dhe do të sigurojnë që anëtarët e tyre të qëndrojnë neutralë në këto çështje.
  3. SHRFF mbetet e pavarur dhe shmang çdo formë të ndërhyrjeve të papërshtatshme politike. SHRFF i menaxhon punët e saj në mënyrë të pavarur dhe sigurohet që çështjet e veta të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë.
- 

Neni 7 **Promovimi i marrëdhënieve miqësore**

---

1. SHRFF do të promovojë marrëdhënie miqësore midis anëtarëve të saj, klubeve, zyrtarëve, lojtarëve dhe shoqërisë për objektiva humanitarë.
  2. SHRFF do të sigurojë mjetet e nevojshme institucionale për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje të brendshme që mund të lindë midis anëtarëve, klubeve, zyrtarëve dhe lojtarëve.
- 

Neni 8 **Lojtarët**

---

1. Statusi i lojtarëve dhe dispozitat për regjistrimin e tyre do të rregullohen, në përputhje me Rregulloret e FIFA-s dhe FSHF-se mbi Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve.
2. Lojtarët do të regjistrohen në përputhje me rregulloret e FSHF-së.

---

**Neni 9 Ligjet e Lojës**

---

1. SHRFF dhe secili nga anëtarët e saj do të luajë futboll në përputhje me Ligjet e Lojës të nxjerra nga IFAB. Vetëm IFAB mund të vendosë dhe të ndryshojë Ligjet e Lojës.
2. SHRFF dhe secili nga anëtarët e saj do të luajë minifutboll në përputhje me Ligjet e Lojës për Futsallin të nxjerra nga FIFA. Vetëm FIFA mund të vendosë dhe të ndryshojë Ligjet e Lojës për Futsallin.
3. SHRFF dhe secili nga anëtarët e saj do të luajë futboll në rërë në përputhje me Ligjet e Lojës së Futbollit në Rërë të nxjerra nga FIFA. Vetëm FIFA mund të vendosë dhe të ndryshojë Ligjet e Lojës së Futbollit në Rërë.

---

**Neni 10 Sjellja e organeve, zyrtarëve dhe e të tjerëve**

---

1. Të gjitha organet dhe zyrtarët e SHRFF-së duhet të respektojnë statutin, rregulloret, vendimet, dhe dispozitat etike të FSHF-së në aktivitetet e tyre.
2. Çdo person dhe organizatë e përfshirë në lojën e futbollit, minifutbollit dhe futbollit në rërë në territorin e Qarkut Sportiv Fier, është i detyruar të respektojë statutin dhe rregulloret e FIFA-s, UEFA-s, FSHF-së dhe statute të tjera sipas rastit, si edhe parimet e lojës së drejtë, të ndershme, të integritetit dhe sportivitetit.

---

**Neni 11 Gjuhët zyrtare**

---

1. Gjuha zyrtare e SHRFF -së është gjuha shqipe. Dokumentet dhe tekstet zyrtare do të shkruhen në këtë gjuhë.
2. Gjuha zyrtare në Asamblenë e Përgjithshme është gjuha shqipe.

## II. ANËTARËSIA

---

### Neni 12 Pranimi, pezullimi dhe përjashtimi

---

1. Vendimin për pranimin, pezullimin ose përjashtimin e një anëtari e merr Asambleja e Përgjithshme e SHRFF-së.
  2. Pranimi bëhet nëse kandidati përmbush kërkesat e specifikuara në këtë statut.
  3. Anëtarësia në SHRFF përfundon, me anë të shpërbërjes, dorëheqjes ose përjashtimit të anëtarit. Humbja e anëtarësisë nuk e çliron anëtarin nga detyrimet e tij financiare ndaj SHRFF-së, ose anëtarëve të tjerë të SHRFF-së, të kërkueshme deri në atë moment, por çon në humbjen e të gjitha të drejtave në lidhje me SHRFF-në.
- 

### Neni 13 Anëtarësia

---

1. Anëtarësimi në SHRFF është ekskluzivisht i hapur për personat juridikë të përcaktuar në bazë të ligjit "*Për sportin*", të cilët ushtrojnë aktivitet në sportin e futbollit dhe kanë selinë e tyre të regjistruar në Qarkun Sportiv Fier. Anëtarësimi në SHRFF mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë.
2. SHRFF mban një regjistër të anëtarëve të saj. Regjistri përfshin informacionin e mëposhtëm për secilin anëtar:
  - a. numrin unik të identifikimit;
  - b. formën ligjore;
  - c. përfaqësuesin ligjor;
  - d. informacion shtesë, në veçanti lidhur me licencimin e klubit (p.sh. strukturën e klubit, identitetin; rezultatet).

Informacioni i përditësuar i lidhur me germën "a", "b" dhe "c" do të bëhet publik në faqen e internetit të SHRFF-së.

3. Me kërkesë paraprake, SHRFF konfirmon me shkrim statusin e anëtarit.
- 

### Neni 14 Pranimi

---

1. Çdo Klub i cili humbet statutin e anëtarit të drejtpërdrejtë të FSHF për shkak të zbritjes për meritë sportive nga Kategoria e Parë në Kategorinë e Dytë do të konsiderohet, si rregull anëtar i drejtpërdrejtë i SHRFF. Pavarësisht sa më sipër, pranimi i tij do të ratifikohet formalisht nga Asambleja e Përgjithshme e radhës.



2. Çdo person juridik që dëshiron të bëhet anëtar i SHRFF-së duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të SHRFF-së. Sekretari i Përgjithshëm i konfirmon kandidatit paraqitjen e kërkesës.
3. Kërkesa duhet të shoqërohet detyrimisht me dokumentet e mëposhtme:
  - a. Një kopje të vlefshme të statuteve dhe rregulloreve të vërtetuara ligjërisht për zbatimin e statuteve të përmendura (nëse ka);
  - b. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do të veprjë në përputhje me statutin, rregulloret dhe vendimet e SHRFF-se dhe FSHF-së, dhe të sigurojë që këto dokumente do të respektohen gjithashtu, nga anëtarët, klubet, zyrtarët dhe lojtarët e tij/saj (nëse është e zbatueshme);
  - c. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do të veprjë në përputhje me Ligjet e Lojës në fuqi, siç përcaktohet nga IFAB, si dhe Ligjet e Lojës së Futbollit në Rërë dhe Ligjet e Lojës së Minifutbollit, siç përcaktohet nga FIFA;
  - d. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do t'i drejtohet si shkallë e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha forumeve të brendshme të FSHF-së) për çdo mosmarrëveshje të dimensionit kombëtar që lind ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHF-së vetëm të një gjykate arbitrazhi të pavarur dhe të krijuar në mënyrën e duhur, e cila do të zgjidhë përfundimisht mosmarrëveshjen duke përjashtuar çdo gjykatë të juridiksionit të zakonshëm, përveç se kur ndalohej shprehimisht nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
  - e. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se çdo mosmarrëveshje e nivelit ndërkombëtar që lind ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s ose të UEFA-s mund të paraqitet në shkallën e fundit në CAS, siç specifikohet në statutin e FIFA-s dhe të UEFA-s;
  - f. Një deklaratë ku kandidati vërtetohet se është i regjistruar dhe ka selinë në territorin e Qarkut Sportiv Fier;
  - g. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se përbërja e tij ligjore garanton se ai mund të marrë vendime në mënyrë të pavarur nga ndonjë subjekt i jashtëm dhe të sigurojë që çështjet e tij të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë, në veçanti që ai është i pavarur nga çdo ndërhyrje apo ndikim politik i papërshtatshëm;
  - h. Një deklaratë ku shprehet se anëtarët e organeve të veta janë zgjedhur ose emëruar si rezultat i një procedure që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve, nga çdo ndërhyrje apo ndikim politik i papërshtatshëm;
  - i. Një listë të zyrtarëve, duke specifikuar ata që janë përfaqësues ligjorë, me të drejtë të lidhin marrëveshje ligjërisht të detyrueshme me palë të treta;
  - j. Një kopje të procesverbalit të Asamblesë së Përgjithshme të fundit ose të mbledhjes themeluese;
  - k. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se ai merr përsipër të organizojë ose të marrë pjesë në ndeshje miqësore vetëm me pëlqimin paraprak të SHRFF-së (nëse aplikohet)
  - l. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do të luajë të gjitha ndeshjet zyrtare pritëse në territorin e Qarkut Sportiv Fier, përveç nëse vendoset ndryshe nga autoritetet kompetente (nëse aplikohet).

---

**Neni 15 Kërkesa dhe procedura e aplikimit**

---

1. Sekretariati i Përgjithshëm verifikon përmbushjen e kërkesave të parashikuara në këtë statut dhe përgatit një raport me shkrim për Presidentin.
2. Presidenti do të shqyrtojë raportin me shkrim dhe do të vendosë nëse kërkesa për anëtarësim i plotëson të gjitha kërkesat dhe sipas rastit, Presidenti i kërkon Asamblesë së Përgjithshme të pranojë ose jo kandidatin. Kandidati mund të deklarojë arsyet e kërkesës të tij para Asamblesë së Përgjithshme.
3. Anëtari i ri do të fitojë të drejtat dhe detyrat e anëtarësisë në momentin e pranimit. Delegatët e tij kanë të drejtë të votojnë me efekt të menjëhershëm.

---

**Neni 16 Të drejtat e anëtarëve**

---

1. Anëtarët e SHRFF-së gëzojnë të drejtat e mëposhtme:
  - a) Të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të njihen më parë me rendin e ditës së çdo Asambleje të Përgjithshme, të ftohen në Mbledhjen e Asamblese se Përgjithshme në kohën e përcaktuar, të ushtrojnë të drejtën për të diskutuar dhe debatuar në Asamble dhe të ushtrojnë të drejtën për të votuar.
  - b) Të paraqesin propozime për t'u përfshirë në rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme (e aplikueshme për anëtarët e drejtpërdrejtë);
  - c) Të propozojnë kandidatë për zgjedhje dhe/ose emërim në organet përkatëse të FSHF-së (e aplikueshme për anëtarët e drejtpërdrejtë);
  - d) Të informohen për çështjet e SHRFF-së përmes organeve të saj zyrtare dhe të informohen për vendimet e marra;
  - e) Të marrin pjesë në gara (nëse është e zbatueshme) dhe/ose aktivitete të tjera sportive të organizuara nga SHRFF dhe/ose FSHF-ja dhe të organizojnë kampionat pas delegimit te kesaj të drejte nga FSHF-ja dhe nën kujdesin e saj;
  - f) Të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tjera që burojnë nga statuti dhe në përputhje me rregulloret dhe vendimet e SHRFF-së dhe FSHF-së;
2. Ushtrimi i këtyre të drejtave i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të tjera në këtë statut dhe në rregulloret e zbatueshme të SHRFF-së dhe FSHF-së.

---

**Neni 17 Detyrimet e anëtarëve**

---

1. Anëtarët e SHRFF-së kanë detyrimet e mëposhtme:

- a) Të jenë besnikë ndaj SHRFF-së dhe FSHF-së, që do të thotë se ata nuk duhet të veprojnë kundër interesave të tyre;
- b) Të respektojnë plotësisht statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e SHRFF-ë dhe FSHF-së në çdo kohë dhe të sigurojnë që ato të respektohen edhe nga anëtarët, lojtarët dhe zyrtarët e tyre;
- c) Të sigurojnë zgjedhjen e organeve vendimmarrëse të paktën çdo 4 vjet;
- d) Të mbledhin organin e tyre më të lartë dhe legjislativ në intervale të rregullta, si rregull i përgjithshëm një herë në vit;
- e) Të marrin pjesë në gara (nëse është e zbatueshme) dhe aktivitete të tjera sportive të organizuara nga SHRFF-ja;
- f) Të paguajnë kuotat e anëtarësisë dhe të jenë të qëndrueshëm sa u takon detyrimeve të tyre financiare, siç përcaktohet në këtë statut ose në rregulloret e SHRFF-së dhe FSHF-së;
- g) Të respektojnë Ligjet e Lojës të përcaktuara nga IFAB, si dhe Ligjet e Lojës së Futbollit në Rërë dhe Ligjet e Lojës së Minifutbollit, të përcaktuara nga FIFA, dhe të sigurojnë që ato të respektohen gjithashtu nga anëtarët e tyre, lojtarët dhe zyrtarët përmes një dispozite posaçme në statutet e tyre;
- h) Të miratojnë një klauzolë ligjore, statutore ku të specifikohet që çdo mosmarrëveshje e nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar që lind ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHF-së mund të referohet në shkallën e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha forumeve të brendshme brenda FSHF) vetëm në gjykatën e arbitrazhit sportiv CAS Lozanë e cila do të zgjidhë çështjen në mënyrë përfundimtare duke përjashtuar çdo gjykatë të juridiksionit të zakonshëm, me përjashtim kur një gjë e tillë ndalohej shprehimisht nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë;
- i) Të miratojnë një klauzolë ligjore ku të specifikohet që çdo mosmarrëveshje e dimensionit ndërkombëtar që lind nga ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s, UEFA-s ose FSHF-së të mund të paraqitet në shkallën e fundit vetëm në CAS, siç përcaktohet në statutin e FIFA-s dhe UEFA-s, dhe FSHF-së;
- j) Të administrojnë punët e tyre në mënyrë të pavarur dhe të sigurojnë që punët e tyre të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë, në përputhje me këtë statut;
- k) Të sigurojnë që organet e tyre të zgjidhen ose të emërohen në përputhje me një procedurë që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve;
- l) T'i komunikojnë SHRFF-së çdo ndryshim në statutin dhe rregulloret e saj, si dhe listën e zyrtarëve të saj, të cilët janë përfaqësues ligjorë me të drejtën për të lidhur marrëveshje ligjërish të detyrueshme me palë të treta;
- m) Të mos mbajnë asnjë marrëdhënie të natyrës sportive me subjektet që nuk njihen ose me anëtarët që janë pezulluar ose përjashtuar;
- n) Të respektojnë parimet e besnikërisë, integritetit dhe sjelljes së mirë sportive si shprehje e lojës së ndershme përmes një dispozite statutore dhe të sigurojnë që këto parime të respektohen edhe nga anëtarët e tyre përmes një dispozite të posaçme statutore;
- o) Të respektojnë pikat e detyrueshme të specifikuara në këtë statut gjatë kohëzgjatjes së anëtarësisë së tyre;
- p) Të administrojnë një regjistër të anëtarëve, i cili të përditësohet rregullisht;
- q) Të pajtohen plotësisht me të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga statuti dhe rregulloret e tjera të SHRFF-se dhe dhe FSHF-së.
- r) Të paguajnë kuotën e anëtarësisë pranë SHRFF-së.

2. Anëtarët duhet të integrojnë në statutin e tyre detyrimet e përmendura më sipër, për të qenë të zbatueshme për anëtarët e tyre.
3. Shkelja e detyrimeve të përmendura më sipër nga çdo anëtar mund të çojë në sanksionet e parashikuara në këtë statut.
4. Çdo anëtar i SHRFF-së është përgjegjës në raport me të, lidhur me çdo akt dhe të gjitha aktet e anëtarëve të organeve të tyre të shkaktuara nga neglizhenca ose sjellja e qëllimtë e pahijshme e këtyre anëtarëve.

---

**Neni 18      Pezullimi**

---

1. Çdo Klub i cili për shkak të meritës sportive ngjitet nga Kategoria e Dytë në Kategorinë e Parë do të konsiderohet, si rregull, anëtar i drejtëpërdrejtë i FSHF duke u pezulluar nga të drejtat e tij si anëtar i SHRFF-së. Pavarësisht sa më sipër, pezullimi i tij do të ratifikohet formalisht nga Asambleja e Përgjithshme e radhës.
2. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për pezullimin e një anëtari që shkel seriozisht dhe/ose në mënyrë të përsëritur detyrimet e tij si anëtar. Megjithatë, Presidenti mund të pezullojë përkohësisht një anëtar të tillë me efekt të menjëhershëm. Pezullimi zgjat deri në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme, përveç nëse Presidenti e ka revokuar atë ndërkohë.
3. Anëtari në fjalë ka të drejtën të dëgjohet nga Asambleja e Përgjithshme.
4. Pezullimi i një anëtari nga Asambleja e Përgjithshme ose Presidenti konfirmohet në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme me praninë e shumicës (më shumë se 50%) së anëtarëve me të drejtë vote dhe me shumicën e dy të tretave të votave të hedhura. Nëse nuk konfirmohet, pezullimi revokohet automatikisht.
5. Një anëtar i pezulluar i humbet të drejtat e tij të anëtarësisë. Anëtarët e tjerë nuk mund të kenë kontakte sportive me një anëtar të pezulluar. Komisioni i Disiplinës dhe Etikës së FSHF mund të vendosë sanksione të mëtejshme.
6. Anëtarët që nuk marrin pjesë në aktivitetet sportive të SHRFF-së për 1 (nje) sezon pezullohen automatikisht nga votimi në Asamblenë e Përgjithshme dhe përfaqësuesit e tyre nuk do të zgjidhen ose emërohen derisa të përmbushin detyrimet e tyre në këtë drejtim.

---

**Neni 19      Përrjashtimi**

---

1. Asambleja e Përgjithshme mund ta përjashtojë një anëtar nëse:

- a) shkel rëndë dhe/ose në mënyrë të përsëritur statutin, direktivat dhe/ose rregulloret ose vendimet e SHRFF dhe/ose FSHF-së dhe/ose nuk përmbush detyrimet e nenit 17 të këtij Statuti;
  - b) nuk arrin të përmbushë kërkesat e anëtarësimit të përcaktuara në këtë statut;
  - c) nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij financiare ndaj SHRFF-së;
  - d) nuk merr pjesë në aktivitetet sportive të SHRFF-së për 2 (dy) sezone radhazi.
2. Presidenti ka të drejtë vetëm të propozojë përjashtimin e një anëtari.
  3. Anëtari në fjalë ka të drejtë të dëgjohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe gjithashtu mund t'i përgjigjet me shkrim propozimit për përjashtimin e tij.
  4. Prania e shumicës (më shumë se 50%) së delegatëve që përfaqësojnë anëtarët e kualifikuar për të votuar në Asamblenë e Përgjithshme është e nevojshme në mënyrë që përjashtimi të jetë i vlefshëm, dhe mocioni për përjashtim duhet të miratohet me shumicë prej tre të katërtave të votave të vlefshme të hedhura.

---

**Neni 20 Dorëheqja**

---

1. Një anëtar mund të japë dorëheqjen me efekt nga fundi i një sezoni futbollit (d.m.th. 30 Qershor). Njoftimi për dorëheqjen duhet të mbërrijë në Sekretariatën e Përgjithshme jo më vonë se tre muaj para përfundimit të sezonit përkatës të futbollit.
2. Dorëheqja nuk është e vlefshme derisa anëtari që dëshiron të japë dorëheqjen të ketë përmbushur detyrimet e tij financiare ndaj SHRFF-së dhe anëtarëve të tjerë.

---

**Neni 21 Shpërbërja**

---

1. Nëse një anëtar shpërbëhet, qoftë vullnetarisht ose për shkaqe ligjore, anëtarësia e tij në SHRFF do të përfundojë me efekt të menjëhershëm në momentin që pushon personaliteti i tij juridik.
2. Organi ekzekutiv i anëtarit do të informojë Sekretariatën e Përgjithshme për fillimin e procedurës së shpërbërjes.

---

**Neni 22 Pavarësia e anëtarëve dhe e organeve të tjera**

---

1. Çdo anëtar e menaxhon punën e tij në mënyrë të pavarur dhe pa ndikim të papërshtatshëm nga palët e treta.

2. Organet e anëtarëve do të zgjidhen ose emërohen. Statutet e anëtarëve duhet të parashikojnë një procedurë demokratike që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve.
3. Organet e anëtarëve që nuk janë zgjedhur ose emëruar në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 më sipër, edhe mbi bazë të përkohshme, nuk do të njihen nga SHRFF.
4. Vendimet e miratuara nga organet që nuk janë zgjedhur ose emëruar në përputhje me paragrafin 2 më sipër nuk do të njihen nga SHRFF.

---

Neni **23**      **Statusi i klubeve**

---

1. Klubet e lidhura me SHRFF-në, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, do të varen dhe njihen nga SHRFF. Do të ketë vetëm një kampionat kombëtar të nivelit më të lartë në territorin e SHRFF-së.
2. Ky statut përcakton fushën e veprimit dhe të drejtat dhe detyrat e subjekteve të përmendura në paragrafin 1 më sipër. Statuti dhe rregulloret e tyre do të jenë në përputhje me kërkesat dhe detyrimet e statutit dhe rregulloreve të SHRFF-së.
3. Subjektet e përmendura në paragrafin 1 më sipër do të marrin të gjitha vendimet për çdo çështje në mënyrë të pavarur nga çdo person i jashtëm. Ky detyrim zbatohet pavarësisht nga struktura e tyre e organizimit.
4. Në çdo rast, asnjë person fizik ose juridik (përfshirë shoqëritë *holding* dhe filialet) nuk do të ushtrojë kontroll mbi më shumë se një klub ose grup klubesh sa herë që mund të cenohet integriteti i ndonjë ndeshjeje ose gare.

### III. PRESIDENTI I NDERIT

---

#### Neni 24 Presidenti i Nderit

---

1. Asambleja e Përgjithshme mund t'i jape titullin "President Nderi" çdo personi për shërbime dhe kontribute të shquara ndaj futbollit në Qarkun Sportiv Fier. Në mënyrë që të miratohet kërkesa, kërkohet shumica e dy të tretave të votave të vlefshme.
2. Këto propozime bëhen nga Presidenti. President nderi propozohet vetëm një individ i cili ka kryer më parë detyrën e Presidentit të SHRFF-së.
3. Presidenti i Nderit merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme por pa të drejtë vote.

## IV. ORGANIZIMI

---

### Neni 25      **Organet e SHRFF-së**

---

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë dhe legjislativ.
2. Sekretariati i Përgjithshëm është organi ekzekutiv, operacional dhe administrativ.
3. Komisionet e përhershme dhe të përkohshme këshillojnë dhe Presidentin dhe Sekretariatit e Përgjithshëm për përmbushjen e detyrave të tyre.
4. Çdo anëtar i organeve duhet të tërhiqet nga diskutimet dhe nga marrja e një vendimi nëse ekziston rreziku ose mundësia e konfliktit të interesit. Në veçanti, anëtarët e organeve duhet të jenë gjithmonë të vetëdijshtëm dhe të veprojnë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Etikës të FIFA-s mbi konfliktin e interesit dhe të rregullojnë sjelljen e tyre kur është e nevojshme (p.sh. të abstenojnë nga kryerja e detyrave të tyre, të njoftojnë kryetarin në rastet e konflikteve të mundshme të interesit, etj.).

---

### Neni 26      **Shkarkimi i një anëtari të një organi**

---

1. Presidenti mund të shkarkojë një anëtar të një organi.
2. Anëtari i organit në fjalë ka të drejtë të degjohet.
3. Anëtari i shkarkuar lirohet nga funksionet e tij me efekt të menjëhershëm.



## A. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

---

### Neni 27 Përkufizime dhe përbërja

---

1. Asambleja e Përgjithshme është mbledhja ku anëtarët e SHRFF mblidhen rregullisht dhe përfaqësohen nga delegatë. Asambleja e Përgjithshme përfaqëson autoritetin më të lartë dhe legjislativ të SHRFF-së. Vetëm kur mblidhet sipas rregullave të parashikuara, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të marrë vendime.
2. Asambleja e Përgjithshme konstituohet në përputhje me parimet e demokracisë përfaqësuese dhe merr parasysh rëndësinë e barazisë gjinore, interesat e futbollit të femrave dhe përfaqësimin e ekipeve amatore të regjistruar pranë klubeve anetare të FSHF.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
4. Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga Presidenti, në përputhje me këtë statut, rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme, si dhe çdo rregullore të zbatueshme.
5. Presidenti i Nderit merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme duke u përfshirë në diskutime, por pa të drejtë vote.

### Neni 28 Delegatët dhe votat

---

1. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga anëtarët me të drejtë vote të SHRFF-së.
2. Komisioni i Verifikimit do të përcaktojë numrin e delegatëve.
3. Delegatët duhet t'i përkasin anëtarit që ata përfaqësojnë dhe të emërohen ose zgjidhen nga organi i caktuar nga statuti i anëtarit brenda 20 ditëve nga data e Asamblesë së Përgjithshme. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje ta vërtetojnë këtë gjë. Delegimi i personave jo-anëtarë nuk lejohet.
4. Secili delegat ka të paktën një votë në Asamblenë e Përgjithshme. Për efekt përfaqësimi, cdo anëtar do t'i atribuohet edhe nga një delegat për cdo 100 (njëqind) lojtar të licencuar që marrin pjesë në garat rajonale të të gjitha niveleve. Vetëm delegatët e pranishëm kanë të drejtë vote. Votimi me prokurë ose me letër përfaqësimi nuk lejohet.
5. Sekretariati i Përgjithshëm merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme pa të drejtë vote.

### Neni 29 Fushat e kompetencave

---

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme:

- a) Të miratojë ose ndryshojë këtë Statut dhe Rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme;

- b) Të caktojë tre anëtarë për të kontrolluar procesverbalet dhe për të shqyrtuar procesverbalet e mbledhjes së fundit;
- c) Të zgjedhë Presidentin e SHRFF;
- d) Zgjedhjen e kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura (Komisioni i Verifikimit), me propozimin të Presidentit;
- e) Të emërojë vëzhguesit për të numëruar votat dhe për të ndihmuar Sekretarin e Përgjithshëm për shpërndarjen e fletëve të votimit për zgjedhjet;
- f) Të miratojë pasqyrat vjetore financiare të audituara, përfshirë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin financiar vjetor;
- g) Të miratojë buxhetin;
- h) Të miratojë raportin e aktivitetit, i cili përmban aktivitetet e SHRFF-së që nga Asambleja e Përgjithshme e kaluar;
- i) Të emërojë audituesin e pavarur të jashtëm me propozim të Presidentit;
- j) Të përcaktojë pranimet e anëtarësisë me propozim të Presidentit;
- k) Të japë titullin "President Nderi" me propozimin e Presidentit;
- l) Të pranojë, të pezullojë ose përjashtojë një anëtar;
- m) Të shkarkojë një anëtar të një organi të SHRFF-së;
- n) Të shpërbëjë SHRFF-në dhe të vendosë për përdorimin e aktiveve të saj financiare;
- o) Të miratojë vendimet me kërkesë të një anëtari në përputhje me këtë statut ose të miratojë ndonjë vendim që i është besuar Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me këtë statut.

---

## Neni 30 Kuorumi

---

1. Vendimet e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme do të jenë të vlefshme vetëm nëse në mbledhje, është e pranishme shumica (më shumë se 50%) e anëtarëve me të drejtë vote.
2. Nëse kuorumi nuk arrihet, zhvillohet një Asamble e Përgjithshme e dytë me të njëjtën rend dite brenda 24 orëve.
3. Kuorumi nuk kërkohet për mbledhjen e dytë të Asamblesë së Përgjithshme përveç se nëse në rendin e ditës është e parashikuar një nga çështjet e mëposhtme:
  - a) një ndryshim të këtij statuti apo rregullores së Asamblesë së Përgjithshme;
  - b) zgjedhja e Presidentit;
  - c) zgjedhjen e kryetarëve, nënkryetarëve ose anëtarëve të komisioneve të pavarura;
  - d) shkarkimin e një anëtari të një organi të SHRFF-së;
  - e) pezullimin ose përjashtimin e një anëtari;
  - f) shpërbërjen e SHRFF-së.

Për vendimarrjen për pikat e sipërpërmendura, është e nevojshme shumica e përcaktuar në paragrafin 1 më sipër.

4. Nga momenti që deklarohet se Asambleja e Përgjithshme është thirrur dhe mbledhur në përputhje me këtë statut, kuorumi nuk do të ndikohet nga delegatët që largohen nga mbledhja.

---

**Neni 31 Vendimet**

---

1. Vendimet që hidhen në votë, do të merren me anë të ngritjes së duarve ose me anë të numërimit elektronik, përveçse nëse një e treta e anëtarëve kërkon që të bëhet votim i fshehtë. Nëse ngritja e duarve nuk çon në një shumicë të qartë në favor të një vendimi, votimi do të bëhet duke thirrur listën e delegatëve në rend alfabetik.
2. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë statut, shumica (më shumë se 50%) e votave të vlefshme të dhëna në favor, është e mjaftueshme që një vendim të merret. Fletët bosh të votimit, votat e pavlefshme ose votat elektronike të manipuluar në çdo mënyrë, si dhe abstenimet nuk merren në konsideratë kur llogaritet shumica.

---

**Neni 32 Zgjedhjet**

---

1. Zgjedhjet zhvillohen me votim të fshehtë. Megjithatë, nëse numri i kandidatëve është i barabartë me numrin e pozicioneve të lira, për të cilat mbahen zgjedhjet, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të procedojë ndryshe.
2. Zgjedhjet do të kryhen në përputhje me Rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme të SHRFF-së dhe do të mbikëqyren nga Komisioni i Verifikimit.
3. Kandidatët për president duhet të propozohen nga të paktën 3 (tre) anëtarë. Secili anëtar mund të propozojë vetëm një kandidat për President. Nëse një anëtar mbështet më shumë se një kandidat, asnjë nga shprehjet e mbështetjes së tij nuk do të konsiderohet e vlefshme.
4. Për zgjedhjen e Presidentit, shumica e dy të tretave të votave të vlefshme janë të nevojshme në raundin e parë. Në rast se asnjë kandidat nuk e arrin këtë shumicë, zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve midis dy kandidatëve që kanë marrë shumicën e votave të vlefshme të dhëna në raundin e parë. Në raundin e dytë, kandidati që merr shumicën e votave të vlefshme të dhëna, zgjidhet President. Në rast barazimi, do të zhvillohet raundi i tretë, ku do të zbatohet e njëjta shumicë. Në rast se edhe raundi i tretë përfundon me barazim, Presidenti caktohet me short, i cili hidhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe monitorohet nga Komisioni i Verifikimit.
5. Për zgjedhjen e Presidentit kandidati ose kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
  - a) Të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Shqipëri;
  - b) Të mos jetë dënuar për një krim të rëndë, përfshirë veprën penale të parashikuar nga Neni 197/a i Kodit Penal ose të jetë rehabilituar sipas legjislacionit penal në Republikën e Shqipërisë si dhe të mos jetë i dënuar për trukim ndeshjesh nga organet e FIFA, UEFA ose FSHF;

- c) Të japë një deklaratë me shkrim ku personi deklaron se jep dorëheqjen nga funksionet e tij brenda SHRFF-se, FSHF-së dhe/ose anëtarëve të saj nëse zgjidhet;
  - d) Të jetë nën moshën 70 vjeç në datën e mbajtjes së Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore;
  - e) Të jetë i kualifikuar për rolin;
  - f) Te mos jenë apo të kenë qenë, deputetë, kandidatë për deputetë, anëtarë të organeve drejtuese në ndonjë parti politike, ose funksionar politik në 5 vitet e fundit.
6. Fletët bosh të votimit, votat e pavlefshme ose votat elektronike të manipuluar në çdo mënyrë, si dhe abstenimet nuk merren në konsideratë kur llogaritet shumica.
7. Kandidaturat do të dërgohen në Sekretariatit e Përgjithshëm të paktën 20 ditë para Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore përkatëse. Lista zyrtare e kandidatëve duhet t'u kalohet anëtarëve të SHRFF-së të paktën 10 ditë para Asamblesë së Përgjithshme ku do të zgjidhet Presidenti. Dispozitat e këtij paragrafi do të zbatohen gjithashtu kur zgjedhjet zhvillohen gjatë një Asambleje të Përgjithshme të Jashtëzakonshme.

---

### Neni 33 Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme

---

1. Asambleja e Përgjithshme e zakonshme mbahet çdo vit jo më vonë se data 30 Mars.
2. Presidenti përcakton vendin dhe datën e Asamblesë së Përgjithshme. Anëtarët njoftohen me shkrim të paktën 30 ditë përpara për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
3. Çdo propozim që një anëtar dëshiron t'i paraqesë Asamblesë së Përgjithshme, i dërgohet me shkrim Sekretariatit të Përgjithshëm, me një shpjegim të shkurtër, të paktën 20 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme.
4. Sekretariati i Përgjithshëm, të paktën 10 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme u dërgon anëtarëve me shkrim rendin përfundimtar të ditës, raportin e aktivitetit, pasqyrat financiare, raportin e audituesve të pavarur dhe çdo dokument tjetër të lidhur me rendin e ditës dhe me kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme.

---

### Neni 34 Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme

---

1. Sekretari i Përgjithshëm harton rendin e ditës në bazë të propozimeve të Presidentit dhe anëtarëve.
2. Rendi i ditës së Asamblesë së Përgjithshme përmban çështjet e mëposhtme të detyrueshme (në rend kronologjik):
  - a) Deklarimin e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe përbërjen e saj në përputhje me këtë statut;
  - b) Miratimin e rendit të ditës;
  - c) Fjalimin e Presidentit;

- d) Emërimin e anëtarëve për të kontrolluar procesverbalet;
  - e) Emërimin e Vëzhguesve;
  - f) Pezullimin ose përjashtimin e anëtarëve (nëse aplikohet);
  - g) Miratimin e procesverbalit të Asamblesë së Përgjithshme paraardhëse;
  - h) Raportin e aktivitetit (që përmban aktivitetet që nga Asambleja e Përgjithshme e mëparshme);
  - i) Prezantimin e bilancit të konsoliduar dhe pasqyrave të fitimit dhe humbjes, si dhe raportin e auditorëve të pavarur dhe të jashtëm;
  - j) Miratimin e pasqyrave financiare të audituara;
  - k) Miratimin e buxhetit;
  - l) Votimin për propozimet për ndryshime në këtë statut dhe/ose rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme (nëse është e zbatueshme);
  - m) Diskutimin e propozimeve të paraqitura nga Presidenti ose anëtarët në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë Statut;
  - n) Emërimin e auditorëve të pavarur dhe të jashtëm (nëse është e zbatueshme) me propozim të Presidentit;
  - o) Zgjedhjen e Presidentit (nëse zbatohet);
  - p) Zgjedhjen e delegateve që përfaqësojnë SHRFF-në në Asamblenë e Përgjithshme të FSHF-së në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Asamblesë së FSHF-së në përputhje me Nenin 3 të Rregullores së Asamblese së Përgjithshme të FSHF-së.
  - q) Pranimin për anëtarësim (nëse është e zbatueshme).
3. Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim për pikat të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës.
4. Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme mund të ndryshohet me kusht që dy të tretat e anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të bien dakord me një kërkesë të tillë.

---

**Neni 35 Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme**

---

1. Presidenti mund të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme në çdo kohë.
2. Presidenti e mbledh Asamblenë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme nëse dy e treta e anëtarëve të SHRFF-së bëjnë një kërkesë të tillë me shkrim. Kërkesa përcakton pikat që do të përfshihen në rendin e ditës. Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme do të mbahet brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës me shkrim. Nëse nuk thirret Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme, anëtarët që e kërkuan atë mund të mbledhin vetë Asamblenë e Përgjithshme e Jashtëzakonshme. Duke vepruar kështu, ata informojnë të gjithë anëtarët e SHRFF-së dhe Presidentin për datën dhe vendndodhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme, së bashku me pikat që do të përfshihen në rendin e ditës në përputhje me paragrafin 3 më poshtë.

3. Anëtarët do të njoftohen për vendin dhe datën të paktën 10 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme.
4. Kur Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme thirret me iniciativën e Presidentit, ai duhet të hartojë rendin e ditës. Kur thirret me kërkesë të anëtarëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga vetë anëtarët. Anëtarët që kanë thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme, të paktën 10 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme duhet t'u dërgojnë anëtarëve dhe Presidentit rendin e ditës dhe çdo dokument tjetër që lidhet me rendin e ditës.
5. Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohet.

---

#### Neni 36 Ndryshimet në statut dhe Rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme

---

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për ndryshimin e këtij statuti dhe Rregullores së Asamblesë së Përgjithshme.
2. Çdo propozim për ndryshim të këtij statuti dhe Rregullores së Asamblesë së Përgjithshme duhet të paraqitet me shkrim me një shpjegim të shkurtër në Sekretariatit e Përgjithshëm nga një anëtar ose nga Presidenti. Është i vlefshëm edhe propozimi i paraqitur nga delegatët që përfaqësojnë një anëtar, me kusht që të jetë mbështetur me shkrim nga të paktën dy delegatë të tjerë që përfaqësojnë anëtarët.
3. Në mënyrë që votimi mbi një ndryshim të statutit dhe/ose të Rregullores së Asamblesë së Përgjithshme të jetë i vlefshëm, duhet të jetë e pranishme shumica (më shumë se 50%) e anëtarëve me të drejtë vote.
4. Propozimi për një ndryshim të këtij statuti dhe të Rregullores së Asamblesë së Përgjithshme do të miratohet vetëm nëse dy të tretat e anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote, votojnë në favor të ndryshimeve të propozuara.

---

#### Neni 37 Procesverbalet

---

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Anëtarët e caktuar për të verifikuar procesverbalet duhet ta bëjnë këtë në mënyrë që procesverbalet t'u dërgohen anëtarëve brenda 30 ditëve nga Asambleja e Përgjithshme. Procesverbali do të konsiderohet i aprovuar nëse, brenda 10 ditëve nga dërgimi i tij, nuk paraqiten kundërshtime me shkrim në Sekretariatit e Përgjithshëm. Në rast të marrjes së ndonjë kundërshtimi, procesverbali vendoset për shqyrtim në rendin e ditës të Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme pasardhëse.

---

Neni 38      **Data e hyrjes në fuqi të vendimeve**

---

Vendimet e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme do të hyjnë në fuqi menjëherë pas përfundimit të Asamblesë së Përgjithshme, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë statut, ose nëse Asambleja e Përgjithshme përcakton një datë tjetër për hyrjen në fuqi të një vendimi.

## B. PRESIDENTI

---

### Neni 39 Kompetencat

---

1. Presidenti zgjidhet me mandat 4 (katër) vjeçar me te drejte rizgjedhje;
2. Presidenti ka kompetencat e mëposhtme:
  - a) Të miratojë vendimet për të gjitha çështjet të cilat nuk hyjnë në kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme ose nuk janë të rezervuara për organe të tjera të SHRFF me ligj ose në bazë të këtij statuti;
  - b) Të sigurojë zbatimin e këtij statuti dhe miratimin e vendimeve ekzekutive të kërkuara për zbatimin e tyre, përfshirë miratimin dhe nxjerrjen e Rregullores së Organizimit të Brendshëm të SHRFF-së, rregulloret për organizimin e komisioneve të përhershme dhe komisioneve të përkohshme ose rregulloreve të tjera përkatëse;
  - c) Të administrojë dhe të drejtojë aktivitetet e SHRFF-së në përputhje me këtë statut;
  - d) Të përgatisë dhe rishikojë buxhetin, duke përfshirë përdorimin e fondeve për shpenzime të papritura në buxhet që nuk tejkalojnë masën 10% të buxhetit vjetor të SHRFF-së, të miratuar në Asamblenë e Përgjithshme më të fundit;
  - e) Të përgatisë, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm, dhe të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme e të Jashtëzakonshme;
  - f) Të emërojë kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e komisioneve të përhershme;
  - g) Të vendosë për krijimin e komisioneve të posaçme nëse është e nevojshme në çdo kohë;
  - h) Të emërojë dhe të shkarkojë Sekretarin e Përgjithshëm;
  - i) Të propozojë audituesit e pavarur dhe të jashtëm në Asamblenë e Përgjithshme;
  - j) Të caktojë zëvendësues për vendet vakante të punës në komisionet e pavarura deri në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme;
  - k) Të ushtrojë të drejtën për të propozuar përfaqësues të SHRFF-së për zgjedhje/emërimet në organe të ndryshme të FSHF-se;
  - l) Të shkarkojë një anëtar të një organi, ose të pezullojë një anëtar të SHRFF-së;
  - m) Të propozojë kandidatura të përshtatshme për titullin "President Nderi" të SHRFF-së;
  - n) Të delegojë kompetencat e tij organeve të tjera;
  - o) Të caktojë vëzhgues të cilët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme pa të drejtë për të debatuar ose për të votuar.
  - p) zbatimin e vendimeve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme përmes Sekretariatit të Përgjithshëm;
  - q) sigurimin e funksionimit efektiv të organeve në mënyrë që ato të arrijnë objektivat e përshkruar në këtë statut;
  - r) mbikëqyrjen e punës së Sekretariatit të Përgjithshëm;
  - s) marrëdhëniet midis SHRFF-se, anëtarëve të saj, FSHF-së, dhe organizatave të tjera.
3. Presidenti kryeson Asamblenë e Përgjithshme dhe ato komisione në të cilat ai është emëruar kryetar.
4. Nëse pozicioni i Presidentit bëhet vakant në kuptimin të këtij statuti, ai zëvendësohet nga Sekretari i Përgjithshëm deri në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme. Kjo Asamble e Përgjithshme do të zgjedhë Presidentin e ri për periudhën e mbetur të mandatit.



5. Çdo kompetencë shtesë e Presidentit përcaktohet në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të SHRFF-së.

---

Neni **40**      **Përfaqësimi dhe nënshkrimi**

---

Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm, mund të nënshkruajnë bashkërisht në emër të SHRFF-së, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe në rregulloret e organizimit të brendshëm të SHRFF-së.

## C. SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM

---

### Neni 41 Sekretariati i Përgjithshëm

---

Sekretariati i Përgjithshëm është organ ekzekutiv, operacional dhe administrativ dhe e kryen detyrat nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm. Anëtarët e Sekretariatit të Përgjithshëm duhet të respektojnë rregulloret e organizimit të brendshëm të SHRFF-së dhe do të përmbushin detyrat e caktuara në mirëbesim.

---

### Neni 42 Sekretari i Përgjithshëm

---

1. Sekretari i Përgjithshëm është drejtuesi ekzekutiv i SHRFF-së. Në mungesë të tij, ai emëron një zëvendësues nga Sekretariati i Përgjithshëm.
2. Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti, në bazë të një marrëveshjeje të rregulluar nga e drejta private dhe duhet të ketë kualifikimet dhe/ose përvojën e nevojshme profesionale. Presidenti është gjithashtu organi përgjegjës për shkarkimin e Sekretarit të Përgjithshëm.
3. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për:
  - a) zbatimin e vendimeve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme dhe në përputhje me direktivat e Presidentit dhe organeve të tjera;
  - b) pjesëmarrjen në Asamblesë të Përgjithshme dhe komisioneve të përhershme dhe të përkohshme;
  - c) organizimin e Asamblesë së Përgjithshme dhe organeve të tjera;
  - d) përpilimin e procesverbalit për mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe komisioneve të përhershme dhe të përkohshme;
  - e) administrimin dhe mbajtjen e llogarive;
  - f) korrespondencën;
  - g) marrëdhëniet me anëtarët, dhe FSHF-ne, nën drejtimin e Presidentit;
  - h) organizimin e Sekretariatit të Përgjithshëm;
  - i) emërimin dhe shkarkimin e personelit që punon në Sekretariatit të Përgjithshëm;
  - j) sigurimin e mbështetjes logjistike dhe operative për zgjedhjet për Komisionin e Verifikimit.
4. Çdo përgjegjësi dhe detyrë shtesë e caktuar për Sekretarin e Përgjithshëm përcaktohet në Rregulloren e Organizimit të Brendshëm të SHRFF-së.
5. Sekretari i Përgjithshëm nuk mund të jetë delegat në Asamblesë të Përgjithshme ose anëtar i ndonjë organi tjetër.

## D. KOMISIONET E PËRHERSHME

---

### Neni 43 Komisionet e përhershme

---

1. Komisionet e përhershme janë:
  - a) Komisioni i Ekipeve Kombëtare Rajonale;
  - b) Komisioni i Zhvillimit dhe Masivizimit;
  - c) Komisioni i Futbollit të Femrave;
  - d) Komisioni i Futbollit të Fëmijëve dhe të Rinjve
2. Anëtarët e secilit komision të përhershëm emërohen nga Presidenti me propozim të anëtarëve të SHRFF-së, ose të Presidentit. SHRFF siguron përfaqësimin e duhur të femrave në komisionet e përhershme. Kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e komisioneve të përhershme caktohen për një mandat 4-vjeçar.
3. Çdo kryetar përfaqëson komisionin e tij të përhershëm dhe e kryen detyrën në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të SHRFF-së.
4. Çdo kryetar cakton datat e mbledhjeve në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, siguron kryerjen e të gjitha detyrave dhe i raporton Presidentit dhe/ose Asamblesë së Përgjithshme.
5. Çdo komision i përhershëm mund t'i propozojë Presidentit ndryshime në dispozitat përkatëse të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të SHRFF-së që kanë të bëjnë me komisionin përkatës.
6. Komisioni i përhershëm nuk ka fuqi vendimmarrëse, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë statut.

---

### Neni 44 Komisioni i Ekipeve Kombëtare Rajonale

---

Komisioni i Ekipeve Kombëtare mbikqyr vepimtarinë e strukturave të SHRFF që lidhen me administrimin dhe zhvillimin e ekipeve kombëtare për meshkuj e femra në të gjitha kategoritë e moshave. Komisioni i Ekipeve Kombëtare përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë.

---

### Neni 45 Komisioni i Zhvillimit dhe Masivizimit

---

Komisioni i Zhvillimit dhe Masivizimit do të jetë kompetent për analizimin e aspekteve themelore të trajnimit dhe zhvillimit teknik të futbollit. Ai është përgjegjës për programet zhvillimore të SHRFF-së, duke hartuar dhe propozuar strategji të përshtatshme për dhënie e suportit dhe monitorimin e zbatimit të strategjive karshi anëtarëve duke ofruar asistencë për çështjet e zhvillimit në përgjithësi. Ky komisioni do të ketë në fokus masivizimin e

futbollin ne Qarkun Sportiv Fier. Komisioni përbëhet nga një kryetar, një nënkryetar dhe të paktën 3 (tre) anëtarë.

---

**Neni 46 Komisioni i Futbollit të Femrave**

---

Komisioni i Futbollit të Femrave mbikqyr veprimtarine e strukturave të Sekretariatit të Përgjithshem lidhur me administrimin, organizimin dhe zhvillimin e garave për femra te organizuara ne Qarkun Sportiv Fier. Komisioni përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë.

---

**Neni 47 Komisioni i Futbollit të Fëmijëve dhe të Rinjve**

---

Komisioni i Futbollit të Fëmijëve dhe të rinjve mbikëqyr veprimtarinë e strukturave të Sekretariatit të Përgjithshem lidhur me administrimin, organizimin dhe zhvillimin e garave për fëmijë dhe të rinj, në përputhje me strategjinë e SHRFF dhe FSHF-së e duke pasur të drejtë të propozojë përmirësime në politikat zhvillimore dhe rregulloret përkatëse apo strukturën e garave. Komisioni përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë.

---

**Neni 48 Komisionet e përkohshme**

---

Presidenti mund, nëse është e nevojshme, të krijojë komisione të posaçme (të përkohshme) për detyra të veçanta dhe një periudhë të kufizuar kohore. Presidenti emëron një kryetar, një zëvendëskryetar dhe numrin e duhur të anëtarëve. Detyrat dhe funksioni i komisioneve të përkohshme përcaktohen në rregulloret të veçanta të miratuara nga Presidenti. Komisioni i Përkohshëm i raporton drejtpërdrejt Presidentit dhe/ose Asamblese se Përgjithshme.

## V. KOMISIONET E PAVARURA

---

### Neni 49 Pavarësia institucionale

---

1. Komisionet e pavarura, si dhe anëtarët e tyre, kryejnë aktivitetet dhe detyrat e tyre plotësisht të pavarur, por gjithmonë në interes të SHRFF dhe në përputhje me statutin dhe rregulloret e saj.

### Neni 50 Komisioni i Verifikimit

---

1. Komisioni i Verifikimit është organi përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në përputhje me Rregulloren e Asamblesë së SHRFF dhe FSHF-së dhe kryerjen e kontrollit të integritetit.
2. Komisioni i verifikimit përbëhet nga 1 kryetar dhe 2 anetare dhe funksioni i Komisionit të Verifikimit rregullohen nga Rregullorja e Asamblese se Pergjithshme e SHRFF-se dhe FSHF-së.

## VI. MASAT DISIPLINORE

---

### Neni 51 Masat disiplinore

---

Masat disiplinore që mund të jepen nga Presidenti dhe janë kryesisht:

1. Për personat fizikë dhe juridikë:

- a) paralajmërim;
- b) vërejtje;
- c) gjobë;
- d) kthim i çmimeve.

## VII. FINANCAT

---

### Neni 52 Periudha financiare

---

1. Periudha financiare e SHRFF-së është një vit, ajo fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
2. Të ardhurat dhe shpenzimet e SHRFF-së menaxhohen në mënyrë që ato të ekuilibrohen gjatë periudhës financiare. Detyrat kryesore të SHRFF-së në të ardhmen garantohen përmes krijimit të rezervave.
3. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për hartimin e pasqyrave vjetore të konsoliduara të SHRFF-së deri më 31 dhjetor, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 53 Të ardhurat

---

Të ardhurat e SHRFF-së përfshijnë:

- a) kuotat vjetore të anëtarëve;
- b) të ardhurat e krijuara nga tregtimi i të drejtave të SHRFF-së;
- c) gjobat e vendosura nga organet e autorizuara;
- d) kuota dhe të ardhura të tjera në përputhje me objektivat e ndjekur nga SHRFF-së;
- e) donacione;
- f) çdo e ardhur tjetër në lidhje me aktivitetet e futbollit;
- g) financime nga FSHF, FIFA dhe nga UEFA.

---

Neni 54      **Shpenzimet**

---

SHRFF mbulon:

- a) shpenzimet e parashikuara në buxhet;
- b) shpenzime të tjera të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme dhe shpenzime që Sekretariati i Përgjithshëm ka të drejtë të kryejë brenda fushës së kompetencave të tij;
- c) të gjitha shpenzimet e tjera në përputhje me objektivat e ndjekura nga SHRFF.

---

Neni 55      **Audituesit e pavarur dhe të jashtëm**

---

Audituesit e pavarur dhe të jashtëm të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme kontrollojnë çdo vit llogaritë e miratuara nga Komisioni i Financave në përputhje me parimet e duhura të kontabilitetit dhe paraqesin një raport para Asamblesë së Përgjithshme. Raporti i auditimit i kalohet pa ndryshime Asamblesë së Përgjithshme për miratim. Audituesit e pavarur dhe të jashtëm emërohen, me propozim të Presidentit, për një periudhë 1-vjeçare. Mandati i tyre mund të rinovohet.

---

Neni 56      **Kuotat e anëtarësisë**

---

1. Kuotat e anëtarësisë për anëtarët e drejtpërdrejtë vendosen nga Asambleja e Përgjithshme dhe paguhen brenda datës 1 Qershor të çdo viti. Kuota vjetore për anëtarët e rinj për vitin në fjalë paguhet brenda 30 ditëve nga përfundimi i Asamblesë së Përgjithshme që i ka pranuar ata.
2. Asambleja e Përgjithshme përcakton shumën e kuotës vjetore çdo dy vite me rekomandimin e Presidentit. Kuota është e njëjtë për çdo anëtar dhe do të jetë jo më shumë se 20.000 (njëzetmijë) Lekë.

---

Neni 57      **Shlyerja**

---

SHRFF mund të debitojë pasuritë dhe llogaritë e çdo anëtari për të shlyer detyrimet që ata kanë ndaj SHRFF-së, FSHF-se ose të tretëve.

---

Neni 58      **Tarifat**

---

SHRFF mund të kërkojë pagimin e një tarife për ndeshjet nga anëtarët e saj.

---

Neni 59      **Botimi i të dhënave financiare**

---

SHRFF boton në faqen e saj zyrtare dokumentet financiare të përmendura në kete statut pasi pikat përkatëse të jenë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.



## VIII. GARAT DHE TË DREJTAT NË GARA DHE NË AKTIVITETE

---

### Neni 60      **Garat**

---

1. SHRFF zhvillon aktivitete futbollit në Qarkun Sportiv Fier përmes organizimit të ndeshjeve/garave me mbulim rajonal ose lokal. Struktura e garës ndërtohet gjithashtu në përputhje me cilësinë e sportit, gjininë, moshën, llojin e futbollit dhe marrëdhëniet profesionale.
2. Garat me shtrirje rajonale janë kampionatet rajonale:  
  
U-19, U-17, U-15, U-13, U-11, U-9, U-7
3. Garat me shtrirje lokale janë:
  - a) Kampionatet e futbollit të shkollave 9-vjeçare, shkollave të mesme të përgjithshme dhe universiteteve;
  - b) Kampionatet e minifutbollit për shkollat e mesme.

---

### Neni 61      **Licencimi i klubeve**

---

SHRFF do të regjistrojë në gara vetëm klubet të cilat përmbushin kriteret e FSHF në lidhje me sistemin e licencimit të klubeve në përputhje me kërkesat minimale të sistemit të licencimit.

---

### Neni 62      **Të drejtat**

---

1. SHRFF dhe anëtarët e saj janë pronarët origjinalë të të gjitha të drejtave që burojnë nga gara dhe aktivitete të tjera që kryehen nën juridiksionin e tyre përkatës, pa asnjë kufizim për sa u përket përmbajtjes, kohës dhe vendit. Këto të drejta përfshijnë, ndër të tjera, çdo lloj të drejte financiare, regjistrim audioviziv dhe radiofonik, të drejtat e riprodhimit dhe transmetimit, të drejtat multimediale, të drejtat e marketingut dhe promovimit dhe të drejtat jomateriale, siç janë emblemat dhe të drejtat që rrjedhin nga ligji për të drejtat e autorit.
2. Presidenti vendos se si dhe deri në çfarë mase përdoren këto të drejta dhe harton rregullore të veçanta për këtë qëllim. SHRFF sigurohet që shitja e këtyre të drejtave të kryhet në mënyrë transparente dhe në përputhje me statutin dhe rregulloret e SHRFF-së, si dhe ligjet kombëtare në fuqi.

---

**Neni 63 Autorizimi për shpërndarje**

---

1. SHRFF dhe anëtarët e saj janë ekskluzivisht përgjegjës për autorizimin e shpërndarjes së imazhit dhe zërit dhe elemente të tjera të të dhënave të ndeshjeve të futbollit dhe ngjarjeve që kryhen nën juridiksionin e tyre përkatës, pa asnjë kufizim.

---

**IX. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

---

**Neni 64 Ngjarje të paparashikuara dhe forca madhore**

---

Presidenti ka kompetencën të vendosë për të gjitha rastet e forcës madhore dhe për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë statut; vendimet e tilla do të marrin parasysh rregulloret përkatëse të FIFA-s dhe UEFA-s, si dhe çdo ligj të zbatueshëm të detyrueshëm.

---

**Neni 65 Botimi i dokumenteve të organizatës**

---

SHRFF-ja boton në faqen e saj zyrtare të internetit dokumentet dhe informacionin e mëposhtëm:

- a) Statutin dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
  - b) Vendimet më të rëndësishme;
  - c) Rendin e ditës për mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme;
- 

**Neni 66 Shpërbërja**

---

1. Çdo vendim në lidhje me shpërbërjen e SHRFF-së kërkon shumicën e dy të tretave të të gjithë anëtarëve të SHRFF-së. Vendimi duhet të merret në një Asamble të Përgjithshme të thirrur posaçërisht për këtë qëllim.
  2. Nëse SHRFF shpërbëhet, pas likuidimit të detyrimeve të saj, asetet e saj i transferohen FSHF-se e cila i mban këto asete si kujdestare.
- 

**Neni 67 Çështje lidhur me anëtarët themelues**

---

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, Anëtarët Themelues të Shoqatës Rajonale Fier konsiderohen se e kanë përmbushur qëllimin e tyre dhe humbasin të drejtën e anëtarësisë duke u zëvendësuar përfundimisht nga anëtarët e listuar në Nenin 13 të këtij statuti.

Ky statut u miratua nga Asambleja e Përgjithshme në Fier më 16.04.2021 dhe hyn në fuqi pas miratimit nga FSHF. Statuti i mëparshëm i SHRFF-së shfuqizohet.

**Për Shoqaten Rajonale te Futbollit Fier**

**Hiqmet Cela**  
**Presidenti**